

**SHQIPËRIA GJATË VITEVE 1961-1985: VËSHTRIM SOCIO-
KULTUROR**

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË

NGA

ENDRIT SADA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

SHTATOR, 2024

Shqipëria gjatë viteve 1961-1985: Vështrim socio-kulturor

Mentori: Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani

Kandidati: Endrit Sada

Punimi i diplomës me titull “*Shqipëria gjatë viteve 1961-1985: vështrim socio-kulturor*” karakterizohet nga një mbështetje e theksuar në dokumente arkivore, shtypin e kohës, revistave shkencore si dhe literaturës relevante për studimin në fjalë. Ky punim diplome ndahet në 3 kapituj:

Kapitulli i parë: trajton rrethanat e përgjithshme politike të Shqipërisë gjatë viteve 1961-1985, duke sjellë kështu elementet themelore që nga prizmi politik determinuan edhe zhvillimet në fushën socio-kulturore. Fusha diplomatike, përkatësisht politika e jashtme e Shqipërisë Socialiste karakterizuar me relacionet shqiptaro-kineze deri në vitin 1978 dhe izolimit diplomatik pas këtij viti merr një trajtesë të veçantë. Rëndësi në këtë kapitull i kushtohet edhe sferës ekonomike, sukseseve dhe dështimeve që u shënuan në këtë segment duke veçuar disa nga projektet më madhore gjatë këtyre viteve. Eliminimet politike që u intensifikuan që nga Plenumi i IV duke filluar nga grupi i kulturës e për të përfunduar tek bashkëpunëtorët më të afërt të Enver Hoxhës trajtohen me një rëndësi të theksuar.

Kapitulli i dytë: trajton proceset themelore dhe më të rëndësishme që karakterizuan fushën sociale gjatë viteve 1961-1985. Filluar me familjen dhe transformimin e saj, nga një model tradicional e konservator në një familje të tipit socialist, që formësohet me norma e parime të reja. Rëndësi themelore i kushtohet religjionit dhe raportit të këtij elementi të rëndësishëm socio-kulturor me diktaturën shqiptare. Lufta ndaj religjionit manifestuar me forma të ndryshme, shpaloset nëpërmjet të dhënave nga burime të ndryshme. Emancipimi i gruas dhe avancimi i pozitës së saj shprehur në fusha të ndryshme si arsimore, politike, legjislative, profesionale etj., është një pjesë tjetër e këtij kapitulli. Lufta e klasave si një nga doktrinat themelore të ideologjisë së diktaturës shqiptare shpaloset me të gjitha format dhe pasojat që la në shoqërinë shqiptare të kohës. Rinia socialiste dhe punëtorët si dy shtresa simbole për regjimin, marrin një trajtim të rëndësishëm duke pasqyruar rëndësinë për sistemin por edhe instrumentalizimin e tyre për qëllime politike.

Kapitulli i tretë: trajtohen aspektet kryesore të jetës kulturore gjatë viteve 1961-1985. Kapitulli fillohet me edukimin socialist duke shpalosur të arriturat kryesore shprehur në institucione, masivizim të pjesëmarrjes në sferën e arsimimit, ngritjes cilësore të kuadrove, rolit

të propagandës në edukim etj. Përparimi i bërë në degët kryesore të kulturës dhe arteve, duke pasqyruar institucionet, veprat dhe figurat kryesore që karakterizuan fushat përkatëse, si ato letrare, teatrale, muzikore, kinematografike etj., marrin një trajtim gjithëpërfshirës duke prekur ngjarjet kryesore. Bashkëpunimi kulturor me vendet e tjera ku në qendër vihet Kosova dhe impakti që pati ky element në popullsinë shqiptare në Kosovë, por edhe pjesëmarrja e figurave kryesore të kulturës shqiptare në arenën ndërkombëtare ka një trajtim të veçantë. Rëndësi i kushtohet edhe aspektit të censurës shtetërore në kulturën dhe artet shqiptare, si dhe autocensurës që vinte si një mekanizëm mbrojtës nga akterët kryesor të kësaj fushe. Mediat me informimin propagandistik që si funksion kryesor kishte përçimin e qëllimeve të Partisë në shoqërinë shqiptare, bashkë me zhvillimet edhe etapat kryesore të saj, në këtë kapitull ka një elaborim gjithëpërfshirës.